



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**LOCAL GOVERNANCE  
PROGRAM IN ALBANIA**

## SUCCESS STORY

# Nënshkruhet huaja e parë tregtare për një njësi të pushtetit vendor

Aftësia e qeverisjes vendore për të marrë huan të mjaftueshme për investimin e projekteve do t'i mundësojë bashkive ofrimin e shërbimeve më të mira për popullsinë dhe për të nxitur me efektivitet rritjen e ekonomisë vendore.



*Drejtori i BKT-së, z. Pekhan Isipek dhe Kryetari i Bashkisë Fushë-Krujë, z. Ismet Mavriqi duke firmosur huanë e parë tregtare për një njësi të qeverisjes vendore në Shqipëri.*

Programi 4-vjeçar për Qeverisjen Vendore në Shqipëri i USAID-it, me vlerë 7.3 milionë dollarë përmirëson qeverisjen në disa bashki dhe ndërton partneritete publik-privat për të krijuar një mjedis 'miqësor për biznesin' në të cilin mund të lulëzojë sektori vendas privat. Veprimtaritë e USAID-it kanë si synim të rrisin investimet, të krijojnë vende pune me qëllimin përfundimtar rritjen e të ardhurave vendore nga taksat.

Në 4 qershor 2009, Bashkia e Fushë-Krujës u bë njësi e parë e pushtetit vendor që merr një hua tregtare. Huaja prej 100 milionë lekësh (afro 1 milionë dollarë) do të përdoret për të përfunduar Unazën Veriore të qytetit, evidentuar nga komuniteti si një projekt thelbësor investimi i nevojshëm për rritjen e ekonomisë vendore dhe për përmirësimin e sigurisë (duke patur parasysh se në qytet qarkullojnë rreth 500 kamionë në orë). Rruga e re do të shmangë trafikun brenda në qytet dhe, për më tepër, kamionët e rëndë nuk do të qarkullojnë brenda qytetit.

Zhvillimi i madh ekonomik i bashkisë nxorri në pah nevojën e ndërtimit të kësaj rruge. Disa fabrika ekzistuese (përfshirë fabrikën e çimentos, fabrikën e tullave dhe qendrat e përpunimit të gëlqeres) përdorin rrugën ekzistuese që kalon përmes qytetit, duke shkaktuar rrëmujë, rreziqe sigurie dhe ndotje të madhe. Bob Solomon, Drejtori i Zhvillimit Korporativ në Fabrikën e Çimentos në Fushë-Krujë theksoi rëndësinë e rrugës së re për biznesin kur deklaronte: "Ndërtimi i Rrugës së Unazës Veriore do të përmirësojë jashtëzakonisht operacionet tona. Me përfundimin e rrugës, do të ulen kostot tona operative dhe ato të partnerëve tanë si dhe do të rritet efijenca."

Rruga e Unazës Veriore ka një gjatësi prej 2.8 km dhe përbëhet nga dy segmente: rruga ekzistuese kombëtare (1.2 km) dhe rruga ekzistuese rurale (1.6 km). Segmenti i parë i rrugës është përgjegjësi e pushtetit qëndror, i cili po e përmirëson këtë segment. Segmenti i dytë, i paasfaltuar dhe me gjerësi vetëm 5-5.5 m, është përgjegjësi e Bashkisë së Fushë-Krujës.

Bashkia me asistencë teknike të Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) përgatiti një Plan afatmesëm të Zhvillimit të Ekonomisë Vendore për bashkinë duke përdorur procesin e pjesëmarrjes. Përparësia kryesore e evidentuar në këtë plan veprim ishte ndërtimi i unazës veriore. Për të zbatuar këtë projekt, LGPA ndihmoi bashkinë për aplikimin dhe negocimin e një huaje me Bankën Kombëtare Tregtare (BKT). Huaja u mbështet edhe nga Autoriteti i Kredive të Zhvillimit i USAID-it, program që mbështet sektorin bankar me anë të garancive të huave për të nxitur kreditimin e bashkive.

Kostoja totale e projekti vlerësohet të jetë 127 milionë lekë. Përveç huasë, bashkia do të përdorë 27 milionë lekë nga buxheti i saj.

"Huaja për Fushë-Krujës," tha Z. Pekhan Isipek, Drejtori i BKT-së, "u dha sepse ai është një projekt i madh dhe bazohet në analizë të shëndoshë ekonomike si dhe nxit zhvillimin ekonomik në qytet. Ne kemi besim se bashkia është një partner i mirë dhe është në pozicion të shkëlqyer për të shlyer huanë. BKT ka kënaqësinë të jetë partner në huanë e parë për pushtetin vendor në Shqipëri."